

## Njoftim për konsultim publik

**ME DATE 10.10.2023, ORA: 11:00, NE AMBJENTET E BASHKISE ELBASAN, KAT:III**

**Titulli i Projekt-vendim :** “Konsultim publik me grupet e interesit për:

- “Draft Plan i Veprimit i Reziliencës Rinore”,

**Propozuesi:** Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak

**Sqarime për projekt-aktin:** Informim i komunitetit të Bashkisë Elbasan mbi Planin e Veprimit a, b, c te draftuar me grupe interesi dhe te konsultuar përpara miratimit me komunitetin.

**Qëllimi i këtij konsultimi është të mblidhen sugjerimet e komunitetit lidhur me:**

Hartimin e planeve vendore të sipërpërmendura.

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimet do të realizohen sipas Kalendarit të Këshillimit Publik.

**Pjesëmarrës :**

- **Nga ana e Bashkisë :** Drejtuesit e Programeve Buxhetore, Drejtorja e Financë, koordinatori per informim dhe konsultim, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, Sektori i Njesise se Integritit European Projekteve Strategjike dhe Inovacionit, Drejtorja e Kujdesit Social, Sherbimeve Komunitare, Teknologjise dhe Medias, përfaqësues të Sekretariatit të Këshillit Bashkiak.
- **Nga komuniteti:** përfaqësues të bizneseve; përfaqësues të OJF-ve; përfaqësues të Këshillit Rinor; përfaqësues të Qendrës së Formimit Profesional; pedagogë dhe studentë të Universitetit “A Xhuvani”; përfaqësues të komunitetit të gjashtë lagjeve dhe dymbëdhjete njësive administrative të Bashkisë Elbasan.
- **Format e konsultimit:** Takime publike, takim me banorët sipas kalendarit si dhe pritja e propozimeve dhe sygjërimeve të tyre me shkrim në zyrën me një ndalesë si dhe kontaktimi i tyre me përfaqësuesin e tyre në Këshill Bashkiak.

Qëllimi i këshillimit publik	Këshillimi publik synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve, biznesit, shoqërisë civile, mësuesve, kryetarëve të fshatrave, strukturave
------------------------------	--

	<p>komunitare ne lidhje me prioritetet që kanë për shërbimet/funksionet e ofruara nga Bashkia qe lidhen me kohezionin social, .....</p> <p>Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacione mbi pritshmerite e grupeve te interesit te perfshire ne takimet e hapura.</p> <p>Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit, do t'i shërbejë Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për të përcaktuar se si do të përdoren fondet publike, fondet nga donatorët, dhe organizatat e shoqerise civile per ti ardhur ne ndihme komunitetit nepermjet institucionalimit te planeve te veprimit qe lidhen me kujdesin social, strehimin, rinine....duhet ti kemi te ndara ne tre njoftime.</p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-vendimi</p>	<p>Miratimi i planeve te veprimit do te jene te integruara edhe me planet buxhetore te institucionit tone.</p>
<p>Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim;</p>	<p>Bashkia Elbasan do të organizojnë 1 konsultim publik me qytetarët dhe me grupet e interesit: biznese, Këshilli Rinor, Përfaqësues të Universitetit Aleksandër Xhuvani, OJF-ve, përfaqësues të Qendrës së Formimit Profesional, strukturave komunitare ne lagje dhe Njësi Administrative, komunitetit etj.</p> <p>Konsultimi do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimit Publik të publikuar në faqen e Bashkisë Elbasan: <a href="http://www.elbasani.gov.al">www.elbasani.gov.al</a>.</p>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen edhe nepermjet pjesemarrjes <b>suaj në takimet publik</b>, por në pamundësi për të marrë pjesë në këto konsultime do të na ndihmoni duke dhënë sygjerimet pranë zyrave me një ndalesë në çdo lagje dhe njësi administrative të Bashkisë Elbasan, si dhe duke kontaktuar me përfaqësuesin e komunitetit si dhe mund të dërgohen në adresën e emailit te kryetarit të Bashkisë Elbasan me email: <a href="mailto:gledianllatja@elbasani.gov.al">gledianllatja@elbasani.gov.al</a> dhe Kryetarit te Këshillit Bashkiak me email: <a href="mailto:lytfti.lala@keshilli.elbasani.gov.al">lytfti.lala@keshilli.elbasani.gov.al</a> , ose</p>

	të dërgohen me postë <b>BRENDA DATËS 10.10.2023</b> ne adresën: <b>Bashkia Elbasan, rruga: pranë Shkollës: Luigj Gurakuqi.</b>
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	Planet e veprimit me pas do te ngarkohen në portalin e institucionit te cilet ne verisionin draft dhe te miratuar ne faqen \e institucionit <a href="http://www.elbasani.gov.al">www.elbasani.gov.al</a> .
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet qe do të ndërmarrë Bashkia Elbasan sëbashku me Këshillin për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	<p>Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit, Bashkia Elbasan dhe Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbajtja e procesverbalit të çdo takimi publik dhe bërja publike e tyre.</li> <li>2. Marrja e Rekomandimeve me postë dhe bërja e tyre publike.</li> <li>3. Realizimin dhe përmbledhje të rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje.</li> <li>4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës dhe çdo këshilltari.</li> <li>5. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës (mbledhjet e komisioneve janë të hapura për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të çdo rekomandimi dhe diskutimi i tij në komision për të dalë me një vendim se cilat propozime mund të merren në konsideratë dhe cilat nuk mund të merren dhe për çfarë arsye.</li> <li>6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre duke i kthyer planet e prioriteteve me plane buxhetore te matshme ne kohe.</li> </ol>
Data e publikimit	19.09.2023
Përgjegjës:	Sektori i konsultimit publik sëbashku me koordinatorin për konsultim dhe me drejtorinë e Inovacionit dhe Medias, pranë Bashkisë Elbasan.

